

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pak pasi kaluan ish-kryeministri britanik dhe disa zyrtarë evropianë, droni rus godet trenin pranë kufirit U krainë-Poloni
ADRESA	https://dosja.al/bota/droni-rus-godet-trenin-prane-kufirit-ukraine-poloni-pak-pasi-aty-kaluan-ish-i514096
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:25:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6445524e2c7319346906890871f4096fbfcf6603705c312175deb934c1aa81b3
TEKSTI	e60b7a876577ae23458a7d000998e1f1982a61c71a9edc7938bd9fd94ca101fd
PAMJA	b0a7550cadd9e2cd5841a5c2d1a1288153759e1138be6b18c3734ca1e693010c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4d5f9e5f8a17947eb7d741da3a359dad8066dc2b9bb48fd0c6ee1a808bd77474
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abbee6aeaf0cbffff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4d5f9e5f8a17947eb7d741da3a359dad8066dc2b9bb48fd0c6ee1a808bd77474>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 ORE ME PARE

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

5 ORE ME PARE

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

5 ORE ME PARE

Nis viti i ri shkollor në sistemin parauniversitar / Rënie e numri të nënësve, trafik i rënduar dhe alarm i rremë për bombë

21 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërisht në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Bota

Pak pasi kaluan ish-kryeministri britanik dhe disa zyrtarë evropianë, droni rus godet trenin pranë kufirit Ukrainë-Poloni

Sulmi goditi lokomotivën e trenit, ndërsa autoritetet ukrainase thanë se nuk pati viktima dhe se pasagjerët ishin evakuuar. Sipas kompanisë shtetërore hekurudhore Ukrzaliznytsia, urdhri për evakuimin ishte dhënë vetëm rreth 15 minuta para goditjes.



14 Shtator 2026, 16:12
Nga E. D



UKRAINË- Një dron rus ka goditur një tren pasagjerësh pranë pikës kufitare Yahodyn, vetëm rreth 2 kilometra nga kufiri me Poloninë, në një incident që ka ngritur shqetësime të reja për përshkallëzimin e sulmeve ruse ndaj infrastrukturës hekurudhore të Ukrainës. Sulmi goditi lokomotivën e trenit, ndërsa autoritetet ukrainase thanë se nuk pati viktima dhe se pasagjerët ishin evakuuar. Sipas kompanisë shtetërore hekurudhore Ukrzaliznytsia, urdhri për evakuimin ishte dhënë vetëm rreth 15 minuta para goditjes.

Incidenti merr një rëndësi të veçantë pasi një tren tjetër, me ish-kryeministrin britanik Boris Johnson dhe zyrtarë të lartë evropianë të sigurisë, kishte kaluar në të njëjtën linjë pak kohë përpara sulmit. Profesoresha Katarzyna Pisarska, kryetare e Forumit të Sigurisë së Varshavës, tha për [BBC](#) se ishte në të njëjtin vagon me Johnson dhe Jonathan Powell dhe se sulmi ndodhi rreth 30 minuta pasi treni i tyre kishte kaluar kufirin polak.

Edhe ish-kryeministri suedez Carl Bildt ndodhej në një nga trenat që po ktheheshin nga Kiev. Pasagjerëve iu kërkua fillimisht të përgatiteshin për evakuim, por treni vijoi më pas drejt Polonisë. Ish-shefi i CIA-s David Petraeus, i cili ndodhej në stacionin Yahodyn në një tjetër tren në momentin e sulmit, e përshkroi incidentin si të tmerrshëm.

Ministria ruse e Mbrojtjes deklaroi se kishte goditur infrastrukturën hekurudhore në Ukrainën perëndimore. Ndërkohë, Ukrzaliznytsia tha se objektivi i dronit mund të ketë qenë treni diplomatik, duke e lidhur këtë dyshim me faktin se ai kishte ndryshuar orarin e nisjes për shkak të kërcënimeve të vazhdueshme ruse.

Pas sulmit reagoi edhe Boris Johnson, i cili kritikoi ashpër Vladimir Putinin dhe bëri thirrje për më shumë mbrojtje ajrore për Ukrainën. Ai e cilësoi sulmin si shembull të sulmeve që ukrainasit përballojnë çdo ditë dhe kërkoi që aleatët e Kievit të sigurojnë urgjentisht sistemet dhe raketat interceptuese të nevojshme.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 14 SHTATOR 2026, 14:44

A do mbushet bregdeti i
Semanit me parqe foto
voltaike? Subashi i Fierit hap
5 tendera për dhënie me qira
të 391 mijë m2 tokë

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49

SKANDAL/ Policia dhunon
protestuesit, momenti kur
efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan
me gusht në bark

Ministri i Jashtëm ukrainas Andrii Sybiha tha se sulmi pranë kufirit me Poloninë tregonte se terrori i Putin po afrohej drejtpërdrejt te kufijtë e BE-së dhe NATO-s. Në Poloni, kryeministri Donald Tusk thirri një takim urgjent, duke paralajmëruar se veprimet ruse po afrohen gjithnjë e më shumë me territorin polak.

Nga ana tjetër, shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, tha se Rusia mund të jetë duke u përpjekur të frikësojë vendet perëndimore. Sipas saj, përgjigjja duhet të jetë e kundërta: Perëndimi duhet të tregojë se vazhdon të mbështesë Ukrainën dhe se nuk ka frikë. Ndërsa, zëdhënësi i Kremlinit Dmitry Peskov tha se ushtria ruse ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë operacione në të gjithë territorin ukrainas.

Incidenti në Yahodyn vjen në një periudhë kur sulmet ruse ndaj infrastrukturës ukrainase janë intensifikuar. Ukraina raportoi se gjatë natës u lëshuan 108 dronë rusë, nga të cilët 85 u rrëzuan. Në sulme të tjera të fundit janë goditur pika kufitare, trena pasagjerësh dhe depo hekurudhore. Rrjeti hekurudhor mbetet jetik për Ukrainën, pasi transporti ajror civil është pezulluar që nga pushtimi i plotë rus në vitin 2022. Ndërkohë, Moska ka akuzuar edhe Ukrainën për sulme ndaj trenave dhe infrastrukturës në territorin rus./Dosja.al

lufta ukraine-rusi

Sondazh

Poll

Releu

14 Shtator 2026, 16:02

Përshtallëzimi i tensioneve gjeopolitike, 12 vende i kërkojnë BE-së të forcojë praninë në Arktik përballë kërcënimit rus

Samiti i zhvilluar në Rovaniemi të Finlandës EVROPË- Dymbëdhjetë vende evropiane i kanë kërkuar Bashkimit Evropian ...

Andy Burnham në zi/ Pas betejës me Alzheimerin, ndërroj jetë i ati i tij

Releu

14 Shtator 2026, 15:42

Aksident tragjik në Afrikën e Jugut/ Raportohen 21 viktima pas përplasjes së dy minibusëve

Releu

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:31

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

më të klikuarat

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca? Ndryshon vetëm drejtimi vendor

Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)

SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektiv i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow

SHBA lajmëron rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, nafta kalon 107 dollarë

[Bota](#)

14 Shtator 2026, 15:21

Irani zgjeron listën e sanksioneve në Hormuz, 77 anije përballen me kufizime

[Bota](#)

14 Shtator 2026, 15:17

[Bota](#)

14 Shtator 2026, 15:10

"Kompanitë kineze nuk e ndihmuan Iranin"/ Kina mohon akuzat për sulmet ndaj bazës amerikane në Jordani

Xi Jinping KINË- Kina ka hedhur poshtë akuzat se kompani kineze i kanë ofruar Iranit imazhe satelitore të një baze ushtarake ameri...

Macron do të vizitoj Spanjën më 29 shtator, vizita e parë zyrtare e një presidenti francez që nga 2009-ta

[Bota](#)

14 Shtator 2026, 14:51

Fundoset një anije me emigrantë në brigjet e Greqisë, 1 i vdekur dhe 25 të zhdukur

[Bota](#)

14 Shtator 2026, 14:45

"Çdo veprim kundër Evropës do të ketë kosto të lartë"/ Ministri i jashtëm polak paralajmëron Rusinë: Nëse ata sulmojnë NATO-n, do ti mposhtim relativisht shpejt

Bota


14 Shtator 2020, 14:40

Qindra adoleshentë rusë përballen me aktakuza për terrorizëm teksa shteti intensifikon shtypjen

Bota

14 Shtator 2020, 14:30

MË SHUMË



Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje



Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës



Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama



Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet!

Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDËSHKAR NGA MediasDesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.